


DAUTI KOMERC

Një gjigant që kujdeset për nevojat e qytetarëve

Kur gjërat e botës shkojnë keq, në Maqedoni ka dikush që del dhe thotë se gjithçka është në rregull dhe këtë praktikë e ka bërë Dauti Komerc që gjatë pandemisë tha se ka ushqim për të gjithë. Edhe tani, në një sfidë të qytetarëve me krizën financiare dhe inflacionin, del përsëri Dauti Komerc për të treguar se është këtu kur duhet. Jo rastësisht, ky brend shqiptar në Maqedoni ka ekzistuar në treg për më shumë se 30 vite.



Vite histori sukcesi
Година успешна приказна
Years story of success



Rreth Dauti Komerc:

Dauti Komerc është shoqatë akcionare e afirmuar, udhëheqës dhe lider i shëndoshë në rajon e më gjërë. Fillimet e kompanisë ishin në fshatin Bojanë të Shkupit para 20 vitesh, kurse sot veprojmë në katër shtete me mbi 500 punonjës. Ne synojmë për të siguruar konzistencë dhe përmirsimin e performansave afariste si dhe mirëmbajtjen e pozicionit të aritur në Maqedoni, Kosovë, Mal të Zi dhe Shqipëri. Risitë tona në spektrin e logjistikës na e mundësojnë distribuimin e brendeve të reja me kualitet të lartë të cilat gjithashtu e fitojnë besimin e konsumatorit. Rezultatet e deritanishme të cilat i kemi treguar dhe besimin të cilin e kemi aritur tek konsumatorët tanë në nivel global, rezultojnë me përf forcimin e pozicionit tonë konkures në tregjet e njohura në rajon dhe më gjërë, si kompani e cila është e aftë për ambientim të shpejt me të gjitha kushtet në mjedisin e bizneseve.



Gjendja e rënduar financiare e shoqërisë si pasojë e pandemisë dhe luftës në Ukrainë" ishte përgjigja e Dauti Komerc kur u pyet për një problem të shoqërisë që e kanë zgjidhur, në kuadër të projekteve të përgjegjësisë shoqërore.

Por, çka ka bërë Dauti Komerc për të zgjidhur një problem. Me këtë zgjidhje ata e kanë fituar të drejtën të jenë në top 10 kompanitë e përfshira në këtë projekt, në rrethin e kompanive të përgjegjshme. I madhi shihet kur i'a jep dorën të voglit dhe e përgatit atë që të "luftojë" i vetëm në jetë. "Ndhimë financiare familjeve të prekura nga kriza aktuale ekonomike nëpërmjet Fondacionit Albiz, si dhe ndihmë për disa kategori të punonjësve duke i shpërblyer financiarisht, që sadopak të ndikojmë në përmirësimin i gjendjes financiare e cila dukshëm u rëndua në periudhën e fundit si pasojë e pandemisë dhe luftës në Ukrainë. Duke veçuar punonjësit të cilët kanë qenë lojal për 10 dhe 20 vite në Sh.A Dauti Komerc, për të cilët është organizuar një eveniment i veçant ku janë ndarë mirënjohje dhe shpërblime (duke përfshirë edhe shpërblime financiare për të gjithë).

Por a është zgjidhur ky problem në tërësi dhe si ndjehet Dauti Komerc pasi ka vepruar në kushte të jashtëzakonshme? "Nuk mund të themi që plotësisht e kemi zgjidhur këtë problem në shoqëri por me mundësitë tona jemi përpjekur që të lehtësojmë gjendjen e atyre që kanë kontakt direkt apo indirekt me kompaninë tonë më qëllim që ti motivojmë edhe subjektet tjera të kycen në këtë proces. Kjo na bën që të ndjejmë një doze krenarie që jemi pjesë e atyre që kanë mundësi të përmirsojnë gjendjen në shoqëri" janë përgjigjur nga Dauti Komerc.